



Sipas autoritetit të dhënë në Nenin 13 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në seancën e mbajtur më 14.01.2008 ka miratuar:

RREGULLIN MBI INFORMATAT KONFIDENCIALE

KAPITULLI 1

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

- 1.1. Ky Rregull bazohet në të drejtën e Zyrës së Rregullatorit për Energji ("ZRRE") që të bëjë përcaktimin lidhur me atë nëse materiali i veçantë përmban informatën konfidenciale si dhe politikën dhe procedurat për përcaktimin dhe qasjen në informatën e tillë konfidenciale.
- 1.2 Sipas Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, ZRRE ka të drejtë të kërkojë nga secili Aplikant, i Licencuar apo autoritet publik, informata, të dhëna dhe dokumente të nevojshme për përmbushjen e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të saj.
- 1.3 Për të ushtruar këtë të drejtë ZRRE do të:
 - a) sigurojë transparencë duke siguruar që i Licencuari, konsumatorët dhe publiku të kenë qasje të hapur në informata;
 - b) sigurojë që të gjitha informatat jo-konfidenciale janë në dispozicion të publikut nën kushte të njëjta dhe lehtë për t'iu qasur atyre;
 - c) mbrojë interesat konkurruese të të licencuarve, apo cilësdo palë, nga zbulimi i paautorizuar i informatave komercialist të ndjeshme ; dhe
 - d) sigurojë se ka një shkallë të mjaftueshme të besimit dhe njohurisë për pjesëmarrësit e tregut për të operuar në treg.
- 1.4 Të gjitha informatat e pranuar nga ZRRE-ja në përmbushjen e aktiviteteve të saja rregullative do të konsiderohen si informata publike përveç nëse janë të përcaktuara si konfidenciale sipas këtij Rregulli.

Neni 2

Definicionet dhe Interpretimi

- 2.1. Termet e përdorura në këtë Rregull do të kenë domethënien si në vijim:

“Aplikanti” do të thotë çdo palë e cila ka aplikuar në ZRRE për licencë, zgjidhjen e kontesteve, aprovimin e kodeve, tarifave dhe çmimeve, certifikatë të privilegjitit, certifikatë për energjinë e ripërtëritshme apo që ka kërkuar nga ZRRE të kryej çfarëdo aktiviteti nga ato që është i autorizuar të rregullojë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

“Informatë Konfidenciale” do të thotë informata që ka të bëjë me të dhënat, dokumentet apo informatat tjera, nëse janë ato komerciale apo teknike, lidhur me dizajnin, rehabilitimin, sigurimin, operimin, mirëmbajtjen, dhe financimin e operimeve apo aktiviteteve që kanë të bëjnë me energjinë, që tashmë nuk gjinden në sferën publike dhe zbulimi i të cilave mund të rrezikojë interesin komercial të aplikantëve dhe/apo të të licencuarve.

“Pala e interesuar” do të thotë aplikanti për licencë, i Licencuari, pala në mosmarrëveshje (kontest) apo çdo palë që mund të ketë ndonjë interes në çfarëdo informate të pranuar nga ZRRE-ja gjatë rrjedhës së përditshme të punës;

“Informata publike” do të thotë informata të mbledhura, grumbulluara apo të mbajtura nga institucioni qeveritar apo kur institucioni qeveritar apo çfarëdo institucioni tjetër ka të drejtë qasjeje, apo çfarëdo informate që posedon ZRRE-ja që nuk është konfidenciale.

“Anëtari i Stafit” do të thotë çdo anëtar i stafit të ZRRE-së duke përfshirë edhe Kryesuesin dhe Anëtarët e Bordit të ZRRE-së.

- 2.2. Termet e përdorura në këtë Rregull do të kenë të njëjtën domethënie si termet e përdorura në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë dhe ligjet dhe rregulloret tjera të zbatueshme në Kosovë.

KAPITULLI 2

INFORMATA KONFIDENCIALE

Neni 3

Kriteret për Përcaktimin e Konfidencialitetit të Informatave

- 3.1 Për t’u konsideruar se informata është konfidenciale ajo duhet t’i përmbush të gjitha kriteret në vijim:
- informata të jetë e ndjeshme nga ana komerciale;
 - zbulimi i informatës do të shkaktojë cenim të interesave konkurrues të të Licencuarit apo palëve tjera që kërkojnë vlerësimin e konfidencialitetit;
 - pala kërkuese ka bërë përpjekje të arsyeshme për të mbajtur fshehtësinë apo konfidencialitetin e informatës, dhe;

- d) dëmtimi i mundshëm që rrjedh nga zbulimi i informatës do të jetë më i rëndë se interesi publik për zbulimin e saj.
- 3.2. Shtojca 1 paraqet udhëzime ilustruese për llojet e informatave që mund të konsiderohen konfidenciale, nëse kriteret nga Neni 3.1 janë përmbushur.

KAPITULLI 3

TRAJTIMI I INFORMATËS QË KONSIDEROHET KONFIDENCIALE

Neni 4

Dorëzimi i Informatës që Konsiderohet Konfidenciale

- 4.1. Të gjitha informatat të pranuar nga ZRRE-ja konsiderohen të jenë publike dhe i nënshtrohen qasjes së plotë për të gjitha palët e interesuara, përveç nëse ZRRE-ja përcakton se një informatë e tillë është konfidenciale sipas dispozitave të këtij Rregulli.
- 4.2. Bordi i ZRRE-së vlerëson se zbulimi i një informate të caktuar mund ta dëmtojë palën apo të tjerët nën kushte të caktuara dhe për këtë mbajtja e konfidencialitetit është e domosdoshme. Prandaj, çdo Aplikant, i Licencuar apo palë e tretë mund të kërkojë që një informatë e caktuar të trajtohet si konfidenciale.
- 4.3. Pala e cila kërkon konfidencialitet të informatës duhet të dëshmojë se informata të cilën kërkon të trajtohet si konfidenciale i përmbush kriteret nga Nenin 3.1.
- 4.4. Informata nga Neni 4.3 duhet të jetë e shënuar nga pala e interesuar si “Informatë Konfidenciale” dhe pala e tillë duhet të kërkojë nga Bordi i ZRRE-së që informata e tillë të përcaktohet si konfidenciale. Kërkesa duhet të përmbajë arsyetim për një përcaktim të tillë.

Neni 5

Rishqyrtimi nga ZRRE-ja

- 5.1. Anëtarët e Stafit të ZRRE-së që merren me dokumentet të cilat përmbajnë informata që janë të shënuara si konfidenciale apo që pranojnë kërkesën për përcaktimin e konfidencialitetit duhet ta sjellin çështjen tek Bordi i ZRRE-së.
- 5.2. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarikë nga data e dorëzimit të kërkesës sipas Nenin 4.4, ZRRE-ja do t'i njoftoj palët e interesuara lidhur me kërkesën e bërë për konfidencialitetin.
- 5.3. Njoftimi duhet të përfshijë një përshkrim të llojit dhe natyrës së informatës si dhe për mundësinë e kundërshtimit të përcaktimit të tillë.

- 5.4. Bordi i ZRRE-së duhet të specifikojë një periudhë të arsyeshme kohore brenda së cilës palët e interesuara mund të kundërshtojnë përcaktimin e tillë dhe të kërkojnë një mundësi që të sjellin prova kundër një kërkesë të tillë. Mundësia duhet të sigurohet përmes një apo më shumë mënyrave si në vijim:
- a) mundësi të mjaftueshme për komente të shkruara;
 - b) argumente verbale në një seancë të Bordit të ZRRE-së.

Neni 6

Përcaktimi i Konfidencialitetit

- 6.1. Informata e shënjuar si konfidenciale nuk do të zbulohet gjersa përcaktimi i konfidencialitetit të jetë bërë nga Bordi i ZRRE-së.
- 6.2. Nëse Bordi i ZRRE-së përcakton se informata e përcaktuar nuk i përmbush kriteret për konfidencialitet, një informatë e tillë do të vihet në dispozicion të publikut në mënyrën e përshkruar në rregullat e miratuara nga ZRRE-ja.
- 6.3. Nëse Bordi i ZRRE-së e përcakton se informata e caktuar i përmbush kriteret për konfidencialitet do të lëshojë një vendim me shkrim duke e shpallë atë si konfidenciale, si dhe arsyetimin për këtë.
- 6.4. Informatat konfidenciale duhet të mbahen dhe të menaxhohen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Doracakun e Punës dhe Rregullin mbi Regjistrin Publik, për të penguar qasjen e paautorizuar dhe zbulimin e saj.

KAPITULLI 4

QASJA DHE ZBULIMI

Neni 7

Qasja në Informata Konfidenciale

- 7.1 Siç parashihet në Nenin 4.1 të Ligjit Nr. 2003/12 mbi Qasjen në Dokumente Zyrtare, ZRRE-ja do të refuzojë qasjen në dokumentin për të cilin institucioni Qeveritar ka përcaktuar se zbulimi do të cenojë mbrojtjen e interesit publik siç është: siguria publike, mbrojtja dhe çështjet ushtarake, marrëdhëniet ndërkombëtare, politika financiare, monetare dhe ekonomike e Qeverisë.
- 7.2. Siç është përcaktuar në Nenin 18.1 të Statutit të ZRRE-së, Bordi do të mbyll pjesën e çfarëdo seance publike kur materiali i cili mendohet të jetë konfidencial është duke u marrë parasysh nga të gjitha palët, përveç atyre personave të cilët janë certifikuar nga Bordi që të kenë qasje në informatën konfidenciale.
- 7.3 Nëse informata është përcaktuar si konfidenciale, secila palë duke përfshirë edhe anëtarët e stafit të ZRRE-së duhet t'i përmbahen kushteve të qasjes në informatën

konfidenciale siç është përcaktuar nga Bordi i ZRRE-së. Ky obligim mbetet në fuqi edhe pas përfundimit të çështjes.

- 7.4 Nëse kërkesa për qasje në informatë konfidenciale është refuzuar, ZRRE-ja do t'i japë arsyet për vendimin e saj në mënyrë që të mos dëmtohen interesat e mbrojtura.
- 7.5 Qasja në informata konfidenciale do t'i jepet çdo personi të aprovuar nga pala e cila konsideron informatën si konfidenciale.
- 7.6 Dispozitat e Neneve 8.2 deri në 8.4 të Ligjit mbi Qasje në Dokumente Zyrtare dhe Nenit 11 të Rregullit mbi Regjistrin Publik lidhur me qasjen, regjistrimin dhe trajtimin e informatave konfidenciale, do të zbatohen.
- 7.7 Siç është përcaktuar në Nenet 13 dhe 50 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë, informata e përcaktuar nga Bordi i ZRRE-së si konfidenciale mund të zbulohet para organeve gjyqësore dhe publike sipas procedurave të vendosura në Rregullat e ZRRE-së.
- 7.8 Përfaqësuesit e autorizuar të palëve të interesuara të cilët marrin pjesë në Seancat e Bordit të ZRRE-së dhe në konsultime mund të kërkojnë autorizim nga Bordi i ZRRE-së për të shqyrtuar informatat konfidenciale. Bordi i ZRRE-së do të autorizojë qasje të tillë në informata konfidenciale nën kushtet si në vijim:
 - a) pasi të konkludoj se pala e interesuar kërkon qasje në mënyrë që të sjell prova adekuate në një çështje të ZRRE-së për të cilën informata është e nevojshme;
 - b) pas dorëzimit të deklaratës së shkruar nga përfaqësuesi i autorizuar që informata nuk do të zbulohet para individëve tjerë që më parë nuk u është autorizuar qasja apo para publikut të përgjithshëm dhe se çfarëdo shkelje e marrëveshjes do t'i nënshtrohet dënimeve.

Neni 8

Obligimet e Anëtarëve të Stafit të ZRRE-së

- 8.1 Bordi i ZRRE-së do të emërojë Anëtarët e Stafit të ZRRE-së të cilëve do t'u lejohet qasja në informata konfidenciale.
- 8.2 Çdo Anëtarë i Stafit që ka qasje në informata konfidenciale do të ketë obligim që të mos e zbulojnë para asnjë pale tjetër asnjë informatë të natyrës konfidenciale që mund të fitohet gjatë rrjedhës së punës së tyre. E njëjta zbatohet edhe për ekspertët të punësuar nga institucionet apo palët tjera të angazhuara në aktivitete rregullative, këshillime, monitorime, auditime dhe aktivitete tjera të kryera në ZRRE.
- 8.3 Obligimi i cili ju ngarkohet personave në Nenin 8.2 është i vlefshëm në çdo kohë gjatë apo pas punësimit në ZRRE. Një person i tillë nuk do të zbulojë, shfrytëzojë apo ndajë informatat e tilla për qëllime tregtare apo për ndonjë qëllim tjetër përveç që t'i kryejnë aktivitetet e tij/saja në ZRRE.

- 8.4. Përdorimi i informatave të tilla për përfitime personale financiare apo për t'i sjellë përfitim të tjerëve, jo vetëm që do të mendohet shkelje serioze e obligimeve nga kontrata, por edhe mund të rezultojë në iniciimin e procedurave civile dhe penale.
- 8.5. Në rast se anëtari i Bordit ka zbuluar informatën konfidenciale, Kryesuesi dhe anëtarët tjerë të Bordit të ZRRE-së do t'i marrin parasysh elementet e dhëna në Nenet 8.2, 8.3 dhe 8.4.

Neni 9

Zbulimi i Paautorizuar

- 9.1. Në rast të zbulimit të paautorizuar të informatës konfidenciale, Bordi i ZRRE-së do të marrë parasysh caktimin e dënimeve apo sanksionet e lejuara me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, Kodin e Sjelljes dhe Etikës dhe rregullat tjera të lëshuara nga ZRRE-ja ndaj çdo anëtarë të Stafit, person apo organ përgjegjës për shkak të zbulim të paautorizuar të informatës konfidenciale.
- 9.2. Nëse një ndalesë-zbulimi sipas Nenin 7.8 është shkelur, Bordi i ZRRE- do të ketë të drejtë të ndalojë pjesëmarrjen e përfaqësuesit të autorizuar në çfarëdo procesi konsultativ të ZRRE-së dhe qasje të ardhshme në çfarëdo informate konfidenciale dhe do të vlerëson nevojën për shqiptimin e gjobës sipas Rregullit mbi Masat Administrative dhe Gjobat.

Neni 10

Zbulimi i Informatave Private dhe Informatave mbi Identifikimin e Personalitetit

- 10.1 Informata private mund të përfshijë emrin e klientit, adresën, numrin e telefonit, dhe çfarëdo informate tjetër që identifikon personalitetin, si dhe informatat që kanë të bëjnë me sasinë, konfigurimin teknik, tipin, destinacionin, përshkrimin e ngarkesës dhe sasinë e shfrytëzimit të shërbimit apo produkteve të dedikuara konsumatorit, që është në dispozicion të të licencuarit në bazë të marrëdhënieve konsumatorë - i Licencuar.
- 10.2 I Licencuari nuk do të zbulojë apo shfrytëzojë çfarëdo informate private lidhur me klientin e vet, apo anëtarët, vartësit, apo çfarëdo pale të tretë për qëllime të marketingut apo ofertave të produkteve që i bëhen klientit i cili tashmë nuk nënshkruhet për atë shërbim apo produkt, përveç nëse i Licencuari e ka fituar më parë lejen me shkrim të klientit për të bërë ashtu.
- 10.3 I Licencuari mund të mbledhë dhe lirojë informatat për klientët në formë të përmbledhjes nëse informatat e mbledhura nuk lejojnë ndonjë klient të veçantë të identifikohet.

KAPITULLI 5

DISPOZITAT E LLOJLLOJSHME

Neni 11 Modifikimi

- 11.1. Ky Rregull mund të modifikohet kohë pas kohe nëse është e domosdoshme që të avancoj synimet e ZRRE-së. ZRRE-ja mund të filloj procedurën e modifikimit të Rregullit me propozimin nga anëtarët e Stafit të ZRRE-së, të Licencuarit, apo çfarëdo pale tjetër.
- 11.2. Procedurat për aprovimin e amendamenteve të Rregullit do të jenë të njëjta si për miratimin e këtij Rregulli.

Neni 12 Gjuha Zyrtare e Rregullës

- 12.1. Ky Rregull është nxjerr në Gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.
- 12.2. Në rast të ndonjë konflikti lidhur me domethënien e shprehjeve të përdorura në këtë Rregull bazuar në gjuhë, versioni në gjuhën Angleze do të mbizotërojë.

Neni 13 Interpretimi

Në rast se ka pika të paqarta dhe mospajtime në dispozita të këtij Rregulli, Bordi i ZRRE-së do të lëshojë informatë shpjeguese.

Neni 14 Hyrja në Fuqi

Ky Rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe publikimit në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

SHTOJCA 1

Që ZRRE-ja të vlerësoj informatën si konfidenciale, ajo duhet ti plotësoj kriteret e përcaktuara në Nenin 3.1.

Si udhëzim, kjo Shtojcë siguron shembuj të llojeve të informatave që mund të cilësohen si konfidenciale.

Lista nuk lë të kuptojë se vetëm ose të gjitha informatat në listë mund të cilësohen si konfidenciale.

- a) informatat komerciale dhe teknike që kanë të bëjnë me dizajnin, rehabilitimin, sigurimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me financimin dhe funksionimin e energjisë;
- b) të dhënat që kanë të bëjnë me pronën intelektuale siç janë fshehtësitë e tregut, patentët, dhe të drejtën e autorit, si dhe planet e biznesit, marketingut dhe shërbimeve, prospektet gjeologjike dhe interpretimet, projektimet, idetë gjeologjike, gjeofizike dhe prodhuese, dizajnet, dhe baza e të dhënave, regjistrimet, dhe çfarëdo të dhënash dhe raportesh financiare të pa publikuara;
- c) të dhënat të cilat mund të cenojnë fshehtësinë dhe integritetin e individit, lidhur me Nenin 10.1 të këtij Rregulli, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale;
- d) pasqyrat financiare që nuk iu lehen në disponueshmëri konkurrentëve të biznesit, duke përfshirë të dhëna për kontabilitetin e brendshëm, planet e biznesit etj;
- e) të dhënat që kanë të bëjnë me aktet ligjore të mbetura pezull;
- f) të dhënat që mund të shfrytëzohen për të fituar qasje në rrjetet e kompjuterëve të kompanisë;
- g) të dhënat që kanë të bëjnë me planin e aplikantit për t'iu drejtuar tregjeve të caktuara; strategjinë e aplikantit lidhur me konkurrentët e caktuar; dhe studimet e tregut të aplikantit dhe analizat, nëse ato nuk janë vënë publikisht në dispozicion;
- h) pasqyrat projektuese, të dhënat e kostos, vlerësimet e projekteve, korrespondenca e projekteve e cila kërkohet të jetë konfidenciale dhe planet kapitale zhvilluese;
- i) informatat të cilat drejtpërdrejt kanë të bëjnë me ofertat, propozimet apo negociatat për shitjen apo blerjen e elektricitetit apo shërbimeve të elektricitetit, zbulimi i të cilave mund të shkaktojë dëmtim të interesave konkurruese për ndërmarrjet e energjisë ose klientëve të tyre;
- j) të dhënat, të cilat nëse zbulohen, do të ndikojnë në inspektimet, hetimet dhe auditimet, përveç nëse është një interes thelbësor i publikut në zbulimin e tyre;

- k) komunikimet ndërmjet të të Licencuarit dhe autoriteteve të ndryshme qeveritare të natyrës këshilluese në masën që ata të mbulojnë materialet tjera dhe jo ato faktike dhe janë hap i parë i politikës së përcaktuar finale apo veprimi, përveç nëse interesi publik është më i rëndësishëm se arsyeja për konfidencialitet;
- l) zbulimi i çfarëdo regjistri apo informate që është i ndaluar me ligjet apo rregulloret tjera.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti
Kryesues

Naim Bejtullahu
Anëtar

Theranda Beqiri
Anëtare

Nysret Avdiu
Anëtar